

VENDIM
Nr.137, datë 11.2.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS
“SKËNDERBEG”, NË BASHKINË E SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës “Skënderbeg”, në bashkinë e Shkodrës.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 287.86 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e gjashtë) m², tokë/truall, dhe 78.85 (shtatëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e pesë) m² ndërtesë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 7 914 549 (shtatë milionë e nëntëqind e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) lekë.

3. Ky fond të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Shkodrës, planifikuar në buxhetin e vitit 2008.

4. Shpenzimet procedurale të përballohen po nga bashkia e Shkodrës.

5. Shpronësimi të përfundojë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndërsa rikonstruksioni i rrugës të përfundojë brenda afateve të parashikuara nga bashkia e Shkodrës.

6. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shkodrës dhe regjistrimi i pasurisë, 287.86 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e gjashtë) m², tokë/truall, dhe 78.85 (shtatëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e pesë) m² ndërtesë, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, me përfundimin e procesit të regjistrimit dhe pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë, pranë bashkisë së Shkodrës. Deri në këtë çast, paratë të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

8. Bashkia e Shkodrës të kryejë likuidimin e pronarëve, sipas dokumentacionit të pronësisë.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PER RIKONSTRUKSIONIN E
RRUGËS “SKËNDERBEG”, BASHKIA SHKODËR

Nr.	Emrat e pronarëve	Sip. trualli i lirë+truall nën objekt m ²	Çmimi për njësi, lekë	Vlera sip. trualli, lekë	Sip. Objekti, m ²	Çmimi për njësi, lekë	Vlera e objektit, lekë	Amortizimi në vite i objektit, lekë	Vlera totale, lekë	Dokumentacioni i pronësisë
1	Tone Frroku	35.1	21564	756896					756896	Vërtetim pronësie
2	Gjyste Marku	36	21564	776304					776304	Vërtetim pronësie
3	Ndrek,etj.Kabashi	33.12	21564	714200	13.5	28350	382725	97978	998947	Vërtetim pronësie
4	Marije Serreqi	27.4	21564	590854	6.5	28350	184275	47174	727955	Vërtetim pronësie
5	Mark Frroku	18	21564	388152					388152	Në proces
6	Adelina Simoni	30	21564	646920	34.6	28350	980910	251113	1376717	Vërtetim pronësie
7	Anton Frroku	25.06	21564	540394					540394	Vërtetim pronësie
8	Mikel Çeka	40.68	21564	877224					877224	Vërtetim pronësie
9	Filip e Eugen Çeka	0		0	18	28350	510300	97977	412323	Vërtetim pronësie
10	Engjëll Çeka	11.5	21564	247986					247986	Në proces
11	Trg. e Shaqir Kadia	24.75	21564	533709					533709	Vërtetim pronësie
12	Muhamet Dizdari	6.25	21564	134775	6.25	28350	177187	34020	277942	Në proces
	Shuma totale	287.86	21564	6207414	78.85	28350	2235397	528262	7914549	

